



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.8

12 shkurt

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 215 datë 21.1.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar..	257
Ligj nr.10 216 datë 21.1.2010	Për detergjentët.....	259
Ligj nr.10 217 datë 21.1.2010	Për disa ndryshime në ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”.....	265
Vendim i KM nr.51, datë 4.2.2010	Për lejimin e kalimit tranzit të një autokolone ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	266
Udhëzim i METE nr.1, datë 26.1.2010	Për përmbajtjen e “Studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit”, për mineralet e grupit 4.....	267
Udhëzim i METE nr.1/1, datë 26.1.2010	Për përmbajtjen e ”Studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit”, për mineralet e grupit 1, 2 dhe 3, shfrytëzimi me karrierë.....	272
Udhëzim i METE nr.1/2, datë 26.1.2010	Për përmbajtjen e ”Studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit”, për mineralet e grupit 1, 2 dhe 3, shfrytëzimi me nëntokë.....	278
Udhëzim i MF&MB nr.4, datë 4.2.2010	Për zbatimin e procedurave të miratimit, mbikëqyrjes dhe përmbylljes së regjimit të lejimit të përkohshëm të automjeteve të huaja për përdorim privat.....	285
Urdhër i MF nr.14, datë 1.2.2010	Për delegim kompetence.....	287
	Vendim <i>i shkurtuar</i> për shpalljen të vdekur të shtetasë Nazmije Goleci.....	288

Vendim <i>i shkurtuar</i> për shpalljen të vdekur të shtetas Meribane Balliu.....	288
Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe më pas të vdekur të shtetasit Arben Allko.....	288

LIGJ
Nr.10 215, datë 21.1.2010

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR” , TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Kufiri minimal i regjistrimit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 5 të këtij neni.”.

Neni 2

Neni 7 “Çregjistrimi” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7
Çregjistrimi

1. Personi i tatueshëm i regjistruar detyrohet të kërkojë çregjistrimin jo më vonë se 15 ditë nga dita e fundit, kur ai ka kryer furnizime të tatueshme, si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike.

2. Personi i tatueshëm, që kërkon të çregjistrohet, u nënshtrohet procedurave të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Personi i tatueshëm detyrohet të çregjistrohet, sipas këtij ligji, vetëm nëse plotëson kushtet sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Organet tatimore refuzojnë të regjistrojnë dhe të çregjistrojnë çdo person, që nuk është as i detyruar dhe as ka të drejtë për t’u regjistruar, me efekt nga data që ky person nuk ka të drejtë të regjistrohet.

5. Në çastin e çregjistrimit, personi i tatueshëm është i detyruar të paraqesë një formular deklarimi, i cili përmban informacionet, që kërkohen nga organi tatimor, si dhe të bëjë pagesën përfundimtare.”.

Neni 3

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19
Furnizimet e përjashtuara

1. Furnizimi është një furnizim i përjashtuar, nëse ai përcaktohet në nenet 20 deri në 25 dhe në nenet 25.1, 25.2, 25.3, 25.5, 25.6, 25.7, 25.8, 25.9 e 26.1 të këtij ligji.

2. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë me udhëzim se cili prej furnizimeve të përjashtuara, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, nuk është një furnizim i përjashtuar në kushte e rrethana të përcaktuara.”.

Neni 4

Pas nenit 24 “Organizatat jofitimprurëse” shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1

Furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore, publike dhe private, në përputhje me ligjet nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1 tetor 2010, është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 5

Pas nenit 25.8 shtohet neni 25.9 me këtë përmbajtje:

“Neni 25.9

Shërbimet ndërkombëtare

Furnizimi i shërbimeve të bëra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga një person i tatueshëm, vendi i veprimtarisë ekonomike të të cilit është në Shqipëri, ose në rastin e një individi, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është në Shqipëri, është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 6

Në nenin 26/1 “Furnizimet e përjashtuara në import”, shkronja “e” shfuqizohet.

Neni 7

Neni 31 “Eksporti dhe shërbimet ndërkombëtare” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

Eksporti dhe transporti ndërkombëtar

TVSH-ja zbatohet në masën zero për qind:

1. Për mallrat, që eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.
2. Për transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve dhe furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me të.

Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit kanë të drejtë të caktojnë me udhëzim të përbashkët cilat janë furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.

3. Për furnizimet e mallrave a shërbimeve në lidhje me veprimtaritë tregtare ose industriale në det.”.

Neni 8

Në nenin 50 “Rimbursimet”, në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.”.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6393, datë 4.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 10 216, datë 21.1.2010

PËR DETERGJENTET

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Ky ligj përcakton rregullat për vendosjen në treg të detergjenteve dhe të lëndëve tensioaktive për detergjentet, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik e të mjedisit, në lidhje me:

- a) biodegradimin e lëndëve tensioaktive në detergjente;
- b) bkufizimet ose ndalimin e përdorimit të lëndëve tensioaktive, për shkak të biodegradimit;
- c) etiketimin e detergjenteve, përfshirë lëndët aromatike alergjene.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. a) “Detergjent” është çdo substancë ose preparat, në formë të lëngët, pluhuri, paste, kallëpi, blloku, figure etj., që përmban sapune dhe/ose lëndë të tjera tensioaktive, i destinuar për t’u përdorur në proceset e larjes dhe të pastrimit, si dhe tregtohen dhe/ose përdoren për qëllime shtëpiake ose industriale.

Detergjente vlerësohen edhe produktet e mëposhtme:

b) “Preparat ndihmës për larje”, i përcaktuar për njomje (paralarje), shpëlarje ose zbardhje rrobash, tekstilesh për përdorim shtëpiak etj.;

c) “Zbutës tekstilesh”, i përcaktuar për të ndryshuar karakteristikat në prekje të tekstileve, në proceset që plotësojnë larjen e tyre;

ç) “Preparat pastrimi”, i përcaktuar për pastruesit shtëpiakë, universalë dhe/ose pastrime të tjera sipërfaqesh.

2. "Larje" është pastrimi i rrobave, tekstileve, enëve dhe sipërfaqe të tjera të forta.
3. "Pastrim" është largimi i një depozitimi të padëshirueshëm mbi dhe/ose në brendësi të substratit, që ndryshon disa karakteristika, pamjen ose ndjesinë e një sipërfaqeje të pastër.
4. "Substanca" janë elementet kimike dhe përbërjet e tyre siç gjenden në natyrë ose të përfuara nga çdo proces prodhimi, përfshirë çdo shtesë të nevojshme për të ruajtur stabilitetin e produkteve dhe çdo papastërti, si pasojë e procesit të përdorur, por duke përfshirë çdo tretës, i cili mund të ndahet nga substanca, pa ndikuar në stabilitetin e saj ose pa ndryshuar përbërjen e saj.
5. "Preparat" është përzjerja ose tretësira, e përbërë nga dy ose më shumë substanca.
6. "Lëndë tensioaktive" është çdo substancë organike dhe/ose preparat, i përdorur në detergjente, i cili vepron në sipërfaqe dhe përbëhet nga një ose më shumë grupe hidrofile dhe një a më shumë grupe hidrofobe, të një natyre dhe me përmasa të tilla, që i japin aftësinë të zvogëlojë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër, të formojë emulsione dhe/ose mikroemulsione dhe/ose micela dhe të thithë në sipërfaqet e kontaktit ujë-trup i ngurtë.
7. "Biodegradim" është një proces, prej të cilit përbërjet kimike organike (përbërjet që përmbajnë karbon) zbërthehen në përbërje më të thjeshta kimike nën veprimin e mikroorganizmave në natyrë.
8. "Biodegradim primar" është ndryshimi strukturor (transformimi) i lëndës tensioaktive nga mikroorganizmat, që shkakton humbjen e vetive aktive sipërfaqësore të saj, për shkak të degradimit të substancës bazë dhe, si rrjedhim, humbjen e vetisë aktive sipërfaqësore, të matur me metodat e testimit, të cilat përcaktohen në rregullin teknik "Për standardet, metodat e testimit, lidhur me biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente".
9. "Biodegradim aerob përfundimtar" është niveli i biodegradimit, që arrihet kur lënda tensioaktive është përdorur krejtësisht nga mikroorganizmat, në prani të oksigjenit dhe që përfundon në shpërbërjen e saj në dioksid karboni, ujë, kripëra minerale të çdo elementi tjetër të pranishëm (mineralizimi) dhe përbërës mikrobialë qelizorë të rinj (biomasa). Përcaktimi i dioksidit të karbonit, ujit dhe kripërave minerale bëhet në bazë të metodave të testimit, të cilat jepen në rregullin teknik "Për standardet, metodat e testimit, lidhur me biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente".
10. "Vendosje në treg" është bërja e disponueshme në treg e detergjenteve dhe e lëndëve tensioaktive për detergjentet për palët e treta, kundrejt pagesës ose falas. Importimi vlerësohet, gjithashtu, vendosje në treg.
11. "Fabrikues" është çdo person fizik ose juridik, përgjegjës për vendosjen në treg të detergjentëve ose të lëndëve tensioaktive për detergjentët. Gjithashtu, vlerësohet fabrikues përfaqësuesi i tij i autorizuar, prodhuesi, importuesi, paketuesi që punon për llogari të tij ose çdo person, që ndryshon karakteristikat e detergjentit a të lëndës tensioaktive të detergjentit, që krijon ose ndryshon etiketimin e tij, kur vetë fabrikuesi nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, si dhe shpërndarësi kur vepron si importues.
12. "Detergjent industrial" është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.
13. "Ministria" është ministria përgjegjëse për çështjet e tregtisë dhe të industrisë.

KREU II KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR DETERGJENTET

Neni 3 Vendosje në treg

1. Kur vendosen në treg, detergjentet dhe lëndët tensioaktive për detergjentet duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij ligji e aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi janë përgjegjës për përputhshmërinë e detergjenteve dhe të lëndëve tensioaktive për detergjentet, me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 4

Biodegradimi i lëndëve tensioaktive

1. Lëndët tensioaktive dhe detergjentet që përmbajnë lëndë tensioaktive vendosen në treg kur plotësojnë kufijtë e lejuar për biodegradimin aerob përfundimtar, të cilët përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave “Për standardet, metodat e testimit dhe kufijtë e lejuar, lidhur me biodegradimin e detergjenteve, si dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente”.

2. Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi i detergjenteve industriale, që përmbajnë lëndë tensioaktive dhe/ose i lëndëve tensioaktive për detergjentet industriale, mund të aplikojnë për përjashtim nga kufijtë e lejuar në rastet kur detergjenti përmban lëndë tensioaktive, për të cilat niveli i biodegradimit aerob përfundimtar është më i ulët se ai i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Aplikimi për përjashtim nga kufijtë e lejuar bëhet në ministri, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Niveli i biodegradimit primar matet për të gjitha lëndët tensioaktive në detergjente, që dështojnë në testimin e biodegradimit aerob përfundimtar. Përjashtimi nga kufijtë e lejuar nuk jepet për ato lëndë tensioaktive të detergjentit, për të cilat niveli i biodegradimit primar është më i ulët se ai i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Lëndët tensioaktive, të cilat, pas vlerësimit të rrezikut në shëndetin publik dhe në mjedis, nuk plotësojnë kufijtë e lejuar për biodegradimin përfundimtar, u nënshtrohen kufizimeve në përdorim, duke pasur parasysh nivelin e teknologjisë për prodhimin dhe vetitë e detergjenteve.

Neni 5

Procedurat për përjashtimin nga kufijtë e lejuar

1. Aplikimi për përjashtim nga kufijtë e lejuar bëhet në ministri nga fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi dhe përmban:

a) kërkesën me shkrim, e cila përmban informacionin për plotësimin e kritereve të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji;

b) dosjen teknike, në të cilën përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm për vlerësimin e aspekteve të sigurisë, në lidhje me përdorimin specifik të lëndëve tensioaktive në detergjente, që nuk arrijnë të respektojnë kufijtë e biodegradimit. Gjithashtu, dosja teknike përmban edhe rezultatet e testeve, të kryera sipas nenit 7 dhe nenit 8 pika 1 të këtij ligji, bazuar në vlerësimin e rrezikut hap pas hapi.

2. Aplikimi për përjashtim, sipas pikës 1 të këtij neni, pranohet për shqyrtim vetëm pas pagimit të tarifës, e cila përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Aplikimi për përjashtim shqyrtohet brenda 6 muajve nga data e pranimit të aplikimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit për përjashtim, ministria ka të drejtë që për vlerësimin e rrezikut, që mund të shkaktojë një substancë dhe/ose një preparat, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të aplikimit, i kërkon aplikuesit informacion shtesë, testimet verifikimi dhe/ose konformiteti për këto substanca dhe/ose preparate a produkte, që ato transformohen, për të cilat ata janë informuar ose kanë pranuar informacionin. Afati kohor për vlerësimin e dosjes fillon pasi dosja është e plotësuar me informacionin shtesë. Nëse informacioni i kërkuar nuk sigurohet brenda 12 muajve, afati i cili fillon nga data e dorëzimit të dokumentacionit, aplikimi vlerësohet i paplotë dhe, si rrjedhim, nuk shqyrtohet.

Aplikuesi mund të kërkojë rishikimin e aplikimit për përjashtim pasi ka plotësuar kërkesat e përcaktuara sipas këtij ligji. Mbi bazën e informacionit të siguruar nëpërmjet dosjes teknike të rishikuar, ministria mund të marrë vendimin për ta zgatur, modifikuar ose hequr përjashtimin.

Nëse kërkohet informacion shtesë për metabolitet, përdoren strategjitë e testeve, në mënyrë që të sigurohet përdorimi maksimal i metodave të testimit *in vitro* dhe metodave të tjera të testimit, që nuk përfshijnë eksperimentet në kafshë.

Metodat e vlerësimit të metaboliteve, që mund të formohen dhe shpërbëhen me vështirësi, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe industrinë.

3. Përrjashtimi nga kufijtë e lejuar të biodegradimit, në varësi të rezultateve të vlerësimit plotësues të rrezikut, lejojnë, kufizojnë ose ndalojnë vendosjen në treg dhe përdorimin e lëndëve tensioaktive, si elemente përbërëse në detergjente.

4. Ministria publikon listën e lëndëve tensioaktive, për të cilat është dhënë përrjashtimi, me kushtet përkatëse ose kufizimet e përdorimit.

Neni 6

Kriteret për përrjashtimin nga kufijtë e lejuar

Ministria, gjatë marrjes së vendimit për përrjashtimin nga kufijtë e lejuar, bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) përdorimin në aplikimet me përhapje të ulët dhe jo në aplikime me përhapje të lartë;
- b) përdorimin vetëm në aplikime të veçanta industriale;
- c) rrezikun në mjedis ose për shëndetin publik, shkaktuar nga vëllimi i shitjeve dhe mënyra e përdorimit, i cili është i ulët në krahasim me përfitimet socialekonomike, përfshirë standardet e sigurisë ushqimore dhe të higjienës.

KREU III

LABORATORËT, INFORMACIONI DHE ETIKETIMI

Neni 7

Testimi i lëndëve tensioaktive

Të gjitha testet e lëndëve tensioaktive kryhen në përputhje me standardet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe me parimet e praktikës së mirë laboratorike.

Neni 8

Autorizimi i laboratorëve dhe pranimit i testeve

1. Ministria pranon testet e kryera vetëm në laboratorë të akredituar.
2. Ministria autorizon laboratorët, të cilët kryejnë testimet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Akreditimi i këtyre laboratorëve bazohet në standardin EN ISO/IEC 17025:2005 ose në kërkesat e praktikës më të mirë laboratorike. Metodatat e testimit, për të cilat këta laboratorë akreditohen, janë metodatat e listuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Mbikëqyrja e laboratorëve të akredituar, të autorizuar nga ministria, kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.
4. Ministria publikon listën e laboratorëve të akredituar e të autorizuar, ku shënohen: emri i plotë i laboratorit, data e miratimit, adresa e laboratorit dhe testi/lista e testeve, për të cilat ky laborator është autorizuar.
5. Kur ministria vërteton se një laborator i autorizuar nuk plotëson kërkesat për autorizim, shfuqizon autorizimin. Nëse mosplotësimi i kërkesave për autorizim ka lidhje me kompetencën teknike të laboratorit, vendimi bazohet në rekomandimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, e cila kryen një mbikëqyrje shtesë. Nëse autorizimi shfuqizohet, emri i laboratorit hiqet nga lista e laboratorëve të autorizuar.
6. Rezultatet e testeve të kryera nga laboratorë, të vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njihen nga ministria kur:
 - a) laboratori, që ka kryer testet, është i akredituar për fushën e testimit nga një organizëm akreditues, i cili ka nënshkruar marrëveshje të njohjes së ndërsjellë me EA-në dhe ILAC-në;
 - b) laboratori, ku është kryer testi, është i akredituar në përputhje me praktikën më të mirë laboratorike nga një organizëm akreditues i njohur nga EA-ja ose ILAC-ja.

Neni 9

Informacioni që sigurohet nga fabrikuesit

1. Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi, që vendos në treg detergjentet ose substancat tensioaktive në detergjente, ka detyrimin të kalojë informacionin e përgjithshëm për produktin përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit.

2. Përveç informacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi vë në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut edhe:

a) informacionin për një ose më shumë rezultate të testeve për biodegradimin përfundimtar;
b) listën e lëndëve tensioaktive, për të cilat është bërë aplikimi për përjashtim nga kufijtë e lejuar, të shoqëruar me:

i) rezultatet e testeve të biodegradimit primar;
ii) rezultatet e testeve dhe informacionin e mbledhur, nëpërmjet vlerësimit plotësues të rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente.

3. Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi është përgjegjës për kryerjen korrekte të testeve përkatëse, pavarësisht nga çasti i vendosjes në treg të detergjenteve ose substancave tensioaktive në detergjente. Ai mban në dispozicion dokumentacionin për testet e kryera, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe ka të drejtë të përfitojë nga e drejta e pronësisë për rezultatet e testeve, me përjashtim të rezultateve të testeve, që janë bërë publike më parë.

4. Për nevoja të interesit publik dhe me kërkesë të Inspektoratit Sanitar Shtetëror, fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi, që vendos në treg detergjentet ose substancat tensioaktive në detergjente, vë në dispozicion të këtij inspektorati, pa vonesë e falas, të dhënat për përbërësit, të cilat ia dërgon brenda 14 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Të dhënat për përbërësit mbahen konfidenciale nga Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe përdoren vetëm për qëllime mjekësore/shëndetësore.

Neni 10

Etiketimi dhe paketimi

1. Detergjentet klasifikohen e paktohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9108, datë 17.7. 2003 “Për substancat dhe preparatet kimike” dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Në paketimin e detergjenteve të vendosura në shitje për konsumatorin, si dhe në të gjitha dokumentet shoqëruese të detergjenteve, në pikat e tregtimit me shumicë jepet në formë të dukshme, lehtësisht të lexueshme dhe të paheqshme, edhe informacioni i mëposhtëm:

a) emri i produktit dhe emri tregtar i produktit;
b) përmbajtja, sipas kushteve specifike, informacioni i nevojshëm për të dhënat e përbërësve për detergjentet, si dhe udhëzimet për përdorim dhe për etiketim, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) adresa e plotë, numri i telefonit, si dhe adresa postare elektronike, kur është e mundur, e personit përgjegjës për vendosjen e produktit në treg, nga të cilat mund të sigurohen të dhënat për përbërësit.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e vendimit për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentet.

KREU IV MBIKËQYRJA E TREGUT

Neni 11

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji për detergjentet kryhet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut në ministrinë përgjegjëse për çështjet e tregtisë dhe të industrisë, e parashikuar

në ligjin nr.9779, datë 16.7.2008 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

Neni 12

Kompetencat e strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut

1. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut ka këto kompetenca, si më poshtë:
 - a) kontrollon për çdo detergjent të vendosur në treg përputhshmërinë e tij me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
 - b) verifikon informacionin e etiketës për zbatueshmërinë e të dhënave të përbërësve dhe dokumentacionin e testimit për biodegradimin;
 - c) merr mostra për teste ose analiza të detergjenteve dhe të lëndëve tensioaktive për detergjente. Në rastet kur rezultatet e testeve tregojnë mospërputhshmërinë e detergjenteve dhe të lëndëve tensioaktive për detergjente me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të gjitha shpenzimet për kryerjen e testimit mbulohen nga personi përgjegjës, që vendos produktin në treg;
 - ç) për çdo detergjent të vendosur në treg, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo të akteve nënligjore në zbatim të tij, që paraqet rrezik për shëndetin publik ose mjedisin:
 - i) urdhëron pezullimin e menjëhershëm të tij dhe lajmëron konsumatorët apo përdoruesit e fundit për rrezikun që ai paraqet;
 - ii) urdhëron ose organizon, së bashku me fabrikuesin, përfaqësuesin e tij të autorizuar, importuesin dhe shpërndarësin, tërheqjen e produktit nga konsumatorët a përdoruesit, si dhe shkatërrimin e tij në kushte të përshtatshme;
 - d) për detergjentet ose lëndët tensioaktive për detergjente, të cilat paraqesin rrezik, përcaktohen kushtet për tregtimin e tyre në mënyrë të sigurt, duke vlerësuar çdo rast në mënyrë individuale dhe me cilësi.
2. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut bashkëpunon me Inspektoratin Sanitar Shtetëror për organizimin e kontrolleve të përbashkëta.

KREU V

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 13

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
 - a) shkelja e përcaktuar në nenin 4 pikat 1 e 4 dhe në nenin 7, me gjobë 1 000 000 lekë;
 - b) shkelja e përcaktuar në nenin 9 pikat 1 dhe 4, me gjobë 100 000 lekë;
 - c) shkelja e përcaktuar në nenin 9 pika 2, me gjobë 300 000 lekë;
 - ç) shkelja e përcaktuar në nenin 10 pikat 1 dhe 2, me gjobë 400 000 lekë;
 - d) për shkelje të kërkesave të parashikuara në nenin 10 pika 3, me gjobë 400 000 lekë;
 - dh) kur subjekti nuk ka pajisur strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut me dokumentacionin e kërkuar, apo kur me veprimet ose mosveprimet e tij e bën të pamundur apo e vështirëson verifikimin e dokumentacionit, me gjobë 100 000 lekë.
2. Shkeljet me karakter administrativ verifikohen dhe dënohen nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, me përjashtim të shkeljes së pikës 4 të nenit 9, për të cilën gjoba vendoset nga Inspektorati Sanitar Shtetëror.

Neni 14

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative

1. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 15 ditëve nga data e konstatimit, por jo më vonë se 2 muaj nga data kur është konstatuar shkelja.

2. Personi, që ka kryer shkeljen, duhet ta shlyejë gjobën brenda 10 ditëve nga data kur ka marrë njoftim për vendosjen e saj.

3. Gjoha e vendosur në zbatim të këtij ligji përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyrat e përmbarimit, në rast se nuk shlyhet në kohë nga personi, që ka vendosur produktin në treg.

4. Të ardhurat, që burojnë nga vjelja e gjobave, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 15

Ankimimi

Kundër vendimit të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, personi, ndaj të cilit është vendosur masa administrative, ka të drejtë të bëjë ankim, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e tregtisë dhe të industrisë për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6394, datë 4.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.10 217, datë 21.1.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9875, DATË 14.2.2008 “PËR METROLOGJINË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 61 “Ankimimi” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 61
Ankimimi

Kundër vendimit të nxjerrë nga inspektori metrolog mund të bëhet ankim në komisionin e ankimit, të kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të këtij komisioni përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.”.

Neni 2

Në nenin 65 “Shqyrtimi dhe ankimi”, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, të dhënë nga inspektori metrolog i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, mund të bëhet ankim, në përputhje me ligjin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Kundër vendimit të komisionit të ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6395, datë 4.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

**VENDIM
Nr.51, datë 4.2.2010**

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOKOLONE USHTARAKE ITALIANE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 7 (shtatë) automjete dhe 14 (katërmëdhjetë) trupa të armatosur në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 6 shkurt 2010, dhe lejimin e kalimit tranzit të po kësaj autokolone në itinerarin porti i Durrësit –Qafë-Thanë, në datën 12 shkurt 2010.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën ushtarake italiane, në datën 6 shkurt 2010, të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën ushtarake italiane, në datën 12 shkurt 2010, të jetë pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Autokolona ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.1, datë 26.1.2010

PËR PËRMBAJTJEN E “STUDIMIT TEKNIKO-EKONOMIK DHE PROJEKTIT TË SHFRYTËZIMIT”, PËR MINERALET E GRUPIT 4

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 15, 17 dhe 70 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Grupi i hartimit të “Studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit”, për mineralet e grupit 4, përbëhet nga:

1. Inxh. gjeolog
2. Inxh. miniere
3. Inxh. topograf ose markshejder
4. Inxh. pasurues (për rastet me impiant përpunimi të xeherorit)
5. Inxh. mekanik, sipas rastit
6. Ekonomist

2. Në rastet kur impianti i përpunimit ndërtohet pas marrjes së lejes minerare dhe në projektin e lejes minerare, të paraqitur nga subjekti, nuk është projektuar impianti/impianetet e përpunimit të xeherorit, subjekti, përpara ndërtimit të një impianti të tillë, duhet të paraqesë projektin e impiantit, sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

3. Përmbajtja tip e ”Studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit”, me karrierë, për këtë grup mineralesh, duhet të ketë karakter teknik zbatimi dhe të jetë si më poshtë:

PËRMBAJTJA E TEKSTIT

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR OBJEKTIN MINERAR

- 1.1 Konsiderata të përgjithshme
- 1.2 Vendndodhja e objektit mineral (dhe impiantit të përpunimi, nëse ka)
- 1.3 Gjeografia e zonës
- 1.4 Popullsia, klima, infrastruktura ekzistuese
- 1.5 Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore

2. TË DHËNA GJEOLGJIKE

- 2.1 Ndërtimi gjeologjik i rajonit
- 2.2 Ndërtimi gjeologjik i vendburimit/vendburimeve
- 2.3 Të dhëna të detajuara mbi vendburimin/vendburimet
- 2.4 Hidrografia dhe hidrogeologjia
- 2.5 Tektonika dhe çarshmëria

- 2.6 Vetitë fiziko-mekanike të shkëmbinjve; kushtet hidrogeologjike
- 2.7 Kushtet tekniko-minerare
- 2.8 Të dhëna mbi llojin e mineralit kryesor të kërkuar për shfrytëzim dhe mineralet e tjera
- 2.9 Punimet e kryera dhe metoda e llogaritjes së rezervave
- 3. PJESA MINERARE**
- 3.1 Të përgjithshme
- 3.2 Zgjedhja e mënyrës së shfrytëzimit, me punime sipërfaqësore
- 3.3 Kapaciteti nxjerrës i minierës, regjimi i punës, ndërresa në ditë, ditë në muaj etj.
- 3.4 Variantet e hapjes së vendburimit, argumentimi dhe zgjedhja e mënyrës së hapjes
- 3.5 Sistemi i shfrytëzimit, treguesit tekniko-ekonomikë të tyre
- 3.6 Radha, drejtimi i shfrytëzimit dhe grafikët e zbulimit dhe prodhimit
- 3.7 Pasaportat e shpim-plasjes në zbulim e prodhim
- 3.8 Argumentimi dhe zgjedhja e pajisjeve të shpimit, ngarkimit dhe transportit, tipet, llojet, karakteristikat e tyre dhe sipas rastit, katalogët përkatës, si dhe zgjidhjet e ndryshme teknike
- 3.9 Zgjedhja e shesheve të depozitimit të sterileve, mbetjeve, apo zbulimit, argumentuar me sasitë e pritshme të tyre, radhën dhe mundësinë e depozitimit të tyre në kohë
- 3.10 Sigurimi teknik në proceset e punës për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit. Zgjidhjet teknike që lidhen me pjerrësinë e skarpatës, gjerësinë e sheshit të punës, si dhe marrja në konsideratë e faktorëve të tjerë gjeomekanikë dhe gjeoteknikë të formacioneve që do të shfrytëzohen apo të atyre rrethues.
- 3.11 Organizimi i punës dhe fuqia punëtore
- 3.12 Parashikimi i prodhimit dhe treguesit tekniko-minerarë të parashikuar
- 4. PJESA NDËRTIMORE**
- 4.1 Rrugët automobilistike për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit
- 4.2 Objektet industriale të shërbimit të makinerive dhe pajisjeve
- 4.3 Objekte sipërfaqësore dhe sociale
- 4.4 Furnizimi me energji elektrike dhe telefoni
- 4.5 Skema e trajtimit të mbetjeve dhe ujërave
- 4.6 Objekte të tjera
- 4.7 Objekte të përpunimit të xeherorit
- 4.7.1 Skema e vendosjes së objektit përpunues, rruga dhe sheshi i furnizimit, vendi i depozitimit të produkteve dhe mbetjeve
- 4.7.2 Furnizimi me energji elektrike dhe ujë
- 4.7.3 Skema teknologjike me treguesit
- 4.7.4 Skema e lidhjes së aparateve me parametrat e punës
- 4.7.5 Skema e kapjes dhe trajtimit të pluhurave
- 4.7.6 Skema e ujit teknologjik, riciklimi apo trajtimi i tij përpara derdhjes në ambient, parametrat e ujit
- 4.7.7 Skema e trajtimit të mbetjeve
- 5. PJESA EKONOMIKE**
- 5.1 Investimet e parashikuara
- 5.2 Investimet për rrugë, sheshe e sistemime
- 5.3 Investimet për ndërtesa industriale

- 5.4 Investimet për ndërtesa sociale
- 5.5 Investimet për makineri, pajisje dhe instalime teknologjike, linja etj.
- 5.6 Llogaritja e kostos së prodhimit deri në produktin e shitshëm
- 5.7 Çmimet e tregut. Marketingu i produktit të gatshëm etj.
- 5.8 Llogaritja e shpenzimeve dhe të ardhurave me metodën Cash-Flow

Tabela përmbledhëse e investimeve dhe grafiku i kryerjes së tyre

Nr.	Emërtimi i investimeve	Vlefata e plotë	Faza e parë	Faza e dytë	Faza e tretë
1.	Rrugë, ndërtim-montime etj.				
2.	Makineri e pajisje				
3.	Investime të tjera				
4.	Pajisje, orendi				
5.	Totali i investimeve				

Afatet kohorë të investimeve sipas fazave

Nr.	Periudha	Fillon	Mbaron
1.	Faza e parë		
2.	Faza e dytë		
3.	Faza e tretë		

Plani i punës për vitin kur kërkohet leja, i cili konsiston në:

Për vitin _____

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti	Tremujorët			
				I	II	III	IV
1.	Zbulim	m ³					
2.	Prodhim	m ³					
3.	Kosto zbulimi	lekë/m ³					
4.	Kosto prodhimi	lekë/m ³					
5.	Shpenzime zbulimi	lekë					
6.	Shpenzime prodhimi	lekë					
7.	Çmimi i shitjes	lekë/m ³					
8.	Përpunim	m ³					
8.1	Produkti 1 i përpunuar	m ³					
8.2	Produkti 2 i përpunuar	m ³					
8.3	Produkti 3 i përpunuar	m ³					
8.4	Produkti 4 i përpunuar	m ³					

8.5	Produkti ... i përpunuar	m ³					
9.	Kosto përpunimi	lekë/m ³					
9.1	Kosto përpunimi për produktin e 1	lekë/m ³					
9.2	Kosto përpunimi për produktin e 2	lekë/m ³					
9.3	Kosto përpunimi për produktin e 3	lekë/m ³					
9.4	Kosto përpunimi për produktin e 4	lekë/m ³					
9.5	Kosto përpunimi për produktin e	lekë/m ³					
10.	Shpenzime përpunimi	lekë					
10.1	Shpenzime përpunimi për produktin e 1	lekë					
10.2	Shpenzime përpunimi për produktin e 2	lekë					
10.3	Shpenzime përpunimi për produktin e 3	lekë					
10.4	Shpenzime përpunimi për produktin e 4	lekë					
10.5	Shpenzime përpunimi për produktin e ...	lekë					
11.	Çmimi i shitjes	lekë/m ³					
11.1	Çmimi i shitjes produkti 1 i përpunuar	lekë/m ³					
11.2	Çmimi i shitjes produkti 2 i përpunuar	lekë/m ³					
11.3	Çmimi i shitjes produkti 3 i përpunuar	lekë/m ³					
11.4	Çmimi i shitjes produkti 4 i përpunuar	lekë/m ³					
11.5	Çmimi i shitjes produkti ...i përpunuar	lekë/m ³					
12.	Të ardhura nga shitja	lekë					
13.	Royalty	lekë					
14.	Pagesë sipërfaqe	lekë					
15.	Studime, projektme	lekë					
16.	Taksa e lejes minerare	lekë					
17.	Taksa e lejes mjedisore	lekë					
18.	Shuma shpenzime	lekë					
19.	Fitimi bruto	lekë					
20.	Tatim fitimi	lekë					
21.	Fitimi neto	lekë					

- 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**
- 7. TË DHËNA MBI IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË HAPJES DHE SHFRYTËZIMIT**
 - 7.1 Humbje e tokës për kullotë
 - 7.2 Humbje e pjerrësisë së tokës
 - 7.3 Ndotja e tokës nga rrjedhjet
 - 7.4 Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta
 - 7.5 Ndotja e tokës nga depozitimi i llumrave
 - 7.6 Erozioni gjatë hapjes dhe shfrytëzimit të objektit mineral
 - 7.7 Bimët e ujit
 - 7.8 Flora dhe fauna
 - 7.9 Trajtimi i ujërave
 - 7.10 Zhurmat gjatë punës së hapjes dhe në objektet e shfrytëzimit
 - 7.11 Pluhurat gjatë procesit të punës në miniera
 - 7.12 Ndikimi në mjedis i produkteve të lëndëve plasëse
 - 7.13 Ndikimi në mjedis i gazeve të mjeteve motorike
 - 7.14 Prodhimi i mbeturinave dhe depozitimi i materialeve që krijohen gjatë hapjes dhe shfrytëzimit të objektit
 - 7.15 Pastrimi, rregullimi dhe rigjenerimi i peizazhit
 - 7.16 Dëmtime të sipërfaqes nga operacionet e gjurmimit
 - 7.17 Ndikimi në infrastrukturën e objektit
 - 7.18 Ndikimi në shëndetin e njerëzve që punojnë në objekt dhe banorëve përreth
 - 7.19 Ndikimi në qarkullimin dhe transportin
 - 7.20 Ndikimi në mjedis i impiantit të përpunimit të xeherorit
 - 7.20.1 Ndotja e tokës nga produktet e ngurta të përpunimit
 - 7.20.2 Ndotja e tokës nga rrjedhjet e llumrave
 - 7.20.3 Ndikimi tek flora, fauna dhe ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore
 - 7.20.4 Trajtimi i ujërave të përdorur, në impiant, riciklimi i tyre
 - 7.20.5 Zhurmat gjatë punës në impiantin e përpunimit
 - 7.20.6 Pluhurat gjatë procesit të punës në impiant dhe trajtimi i tyre
 - 7.21 Plani i monitorimit të mjedisit
- 8. TË DHËNA LIDHUR ME PUNËSIMIN DHE SPECIALIZIMIN E SHITETASVE SHQIPTARË**
- 9. TË DHËNA MBI KËRKESAT E PRITSHME TË INFRASTRUKTURËS DHE MASAT QË DO TË MERREN**

PJESA GRAFIKE

Nr.	Emërtimi	Shkalla
1.	Harta topografike me zonën e kërkuar	1:25.000
2.	Harta gjeologo-topografike e objektit me rrugët e hapjes dhe sheshet e depozitimit të sterileve apo nënprodukteve	1:1.000, 1:2.000
3.	Projeksioni vertikal, planimetria dhe profilet, të plotësuar me azhurnimet faktike të gjendjes (rastet kur ripërtëritet leja)	1:1.000, 1:2.000
4.	Projeksioni vertikal dhe profilet gjatësore e tërthore gjeologo-topografike	1:1.000, 1:2.000
